



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 42 /2020
Datë: 24 / 04 2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt.19.02.2020). Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M Për

Ndryshimin e vendimit nr. 36/202 të datës 16.04.2020

1. Pika 1.6 e vendimit nr. 36/202 të datës 16.04.2020 për emërimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt Udhëzim Administrativ për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, ndryshohet si në vijim:

“1.6. Kemajl Ademaj, Oda e Avokatëve të Kosovës, Anëtar;”

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Në Vendimin e Ministres në detyrë të Drejtësisë nr. 36/202 të datës 16.04.2020 për emërimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt Udhëzim Administrativ për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, është përfshirë edhe Oda e Avokatëve të Kosovës, e përfaqësuar me drejtorin ekzekutiv të Odës.

Me datë 21 prill 2020 nga Oda e Avokatëve të Kosovës në Ministri të Drejtësisë është propozuar Avokati z. Ademaj, për anëtar të grupit punues të cekur më lartë, pra pasi që është nxjerrë vendimi për emërimin e Grupit punues.

Andaj, bazuar në rolin dhe rëndësinë që ka funksioni i Avokatisë, me qëllim që procesi i hartimit dhe finalizimit Projekt Udhëzim Administrativ për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albulena HAXHIU

Ministre në detyrë e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Kabinetit të Ministres;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.